



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI  
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE  
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

---

# EKONOMIA BOTËRORE NË VITIN 2023

ZHVILLIMET AKTUALE NË TREGJET  
NDËRKOMBËTARE

TETOR 2023





KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI  
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE  
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

## RRETH PUNIMIT

### PRITSHMËRITË EKONOMIKE PËR VITIN 2023

Ky punim është përgatitur për të dhënë informacione mbi zhvillimet makroekonomike në tregjet ndërkombëtare mes viteve 2022-2023 dhe parashikimet apo pritshmëritë për ekonominë botërore.

Në punim është studiuar rreth perspektivës makroekonomike të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim e sipër, parashikimet dhe pritshmëritë e rritjes ekonomike sipas rajoneve, ndërprerjet që mund të ndodhin në tregjet financiare, normat e interesit dhe inflacionit, ndikimi i politikave monetare ekspansioniste dhe të shtrënguara, rritja ose zvogëlimi i shpenzimeve publike dhe ekonomia si një rezultat i vendimeve të marra nga politikëbërësit dhe aktorët ekonomikë. Baza e këtij punimi është të përcjellë zhvillimet e ekonomisë botërore për dy vitet e fundit dhe të tregojë pritshmëritë për të ardhmen.



## NË VITIN 2023 PRITET TË KETË TKURJE EKONOMIKE

### NË VITIN 2023 PRITET TË KETË TKURJE EKONOMIKE

Panvarësisht se gjatë 3 tremujorët të vitit 2022 në Eurozonë, SHBA dhe Mbretëri të Bashkuar, ekonomitë treguan një performancë më të mirë se sa ajo që pritej, agjencitë e vlerësimit të kredisë deklaruan se presin stagnim në ekonomitë kryesore dhe të zhvilluara në vitin 2023. Rritjet e njëpasnjëshme të normave të interesit nga bankat kryesore qendrore me qëllim të uljes së inflacionit, përkeqësimi i besimit të konsumatorëve dhe presionet në sektorë kyç si pasuritë e paluajtshme pritet të vazhdojnë deri në fund të vitit 2023. Recesioni pritet ti godet ekonomitë kryesore, duke shkaktuar papunësi më të lartë dhe tkurrje të kërkesës në treg. Nga ana tjetër, politikat monetare ekspansioniste që synohen të zbatohen për të parandaluar recesionin në treg nuk janë shumë të zbatueshme sepse mbartin rrezikun e rritjes edhe më të madhe të inflacionit. Në ekonomitë ku stagnimi dhe inflacioni janë në nivele të larta, politikat monetare kontraktuese mund të shkaktojnë stagflacion.

Pas rritjes së çmimeve, shumica e ekonomive të zhvilluara iu drejtuan rritjes së normave të interesit për të parandaluar inflacionin, gjë që çoi në një lëvizje të lehtë drejt rrënies së inflacionit. Megjithatë, duke qenë se këto politika monetare kontraktuese rritën normat e interesit dhe kostot e kredisë, ato patën efekte negative në ekonomitë reale dhe shkaktuan probleme likuiditeti për bizneset. Prandaj, sfida kryesore me të cilën po përballen pothuajse të gjitha ekonomitë e zhvilluara gjatë vitit 2023 janë politikat që duhet të zgjedhin për të mbajtur ekonominë në ekuilibër. Në këtë rast, është e rëndësishme që politikëbërësit të zgjedhin mes përparësisë së frenimit të inflacionit dhe përparësisë së zbutjes së presioneve sociale që rrjedhin nga rritja e papunësisë si rezultat i politikave kontraktuese monetare.



## PARASHIKIMET

### Treguesit Bazë Makroekonomikë

Rritja e PBB-së	2021	2022	2023
SHBA	5.9	1.9	0.2
Kina	8.1	2.8	4
Eurozona	5.3	3.3	0.2
Japonia	1.7	1.4	1.1
Gjermania	2.6	1.8	-0.5
India	8.7	7	6.2
Anglia	7.5	4.4	-1.2
Franca	6.8	2.5	0.7
Kanada	5	3.5	0.6
Brazili	5	3	0.7

Papunësia	2021	2022	2023
SHBA	5.4	3.7	4.8
Eurozona	7.7	6.8	7.4
Japonia	2.8	2.7	2.7
Gjermania	3.6	3.1	3.4
Anglia	4.5	3.7	5
Franca	7.9	7.6	7.9
Kanada	7.4	5.3	6.1
Italia	9.5	8.3	8.7
Austria	5.1	3.7	4.2
Spanja	14.8	12.9	13

Inflacioni	2021	2022	2023
SHBA	7	7	3.6
Kina	1.5	2.5	5.2
Eurozona	5	10.4	7
Japonia	0.8	3.5	1.5
Gjermania	5.7	12.2	4.1
India	5.7	6.5	5
Anglia	5.4	11.0	4.5
Franca	3.4	7.1	4.4
Kanada	4.8	6.8	3
Brazili	10.1	6	5.2


Normat e interesit	2021	2022	2023
SHBA	0.25	4.5	5
SHBA fitimi 10 vjeqar	1.51	4	4.5
Kina	2.95	2.75	2.75
Eurozona	0	2.5	3.5
Japonia	-0.1	-0.1	-0.1
India	4	6.15	6.15
Anglia	0.25	3.5	4.75
Kanada	0.25	4	4
Brazili	9.25	13.75	11.5
Korea e Jugut	1	3.25	3.5

## PRITSHMËRITË PER VITIN 2023

Pas goditjes së zingjirëve të furnizimit të shkaktuara nga koronavirusi dhe lufta Rusi-Ukrainë, bota tani po përballë me një cikël më ortodoks të makro rreziqeve të nxitura nga nxehja globale, norma e inflacionit të lartë, kufizimet e ofertës dhe shtrëngimi i kushteve monetare. Përderisa gjatë gjithë vitit 2022, rreziqet globale makroekonomike dhe të kredive vazhduan të rriten, shtrëngimi i kushteve monetare nxori në pah dobësitë në aktive të caktuara financiare.

Zhvillimet në ekonominë botërore bënë që në tregun e aksioneve të zhvillohet i ashtuquajtur "Tregu i Arinjëve", (Bear Markets – Bearish Market). Tregu i Arinjëve i referohet situatës në të cilën në një treg me presion të shitjes çmimet bien me 20 përqind nga niveli më i lartë në një periudhë të caktuar (zakonisht një vit). Pra, në këtë treg vëllimi i shitjeve është më i lartë se vëllimi i blerjes.

PARASHIKIMET RRETH SEKTORËVE




Rritja në vëllimin e shitjeve, paqëndrueshmëria ekstreme në tregun e arit në Mbretërinë e Bashkuar, kolapsi i vlerës së kripto valutave në tregun e aktiveve dixhitale dhe presionet në disa tregje udhëheqëse janë të gjitha për shkak të tkurrjes së likuiditetit dhe oreksit për rrezikun e investitorëve.

### Çmimet globale të patundshmërive

Sipas hulumtimeve në tregjet kryesore ekspertët presin që rritja nominale e çmimit të banesave të ngadalësohet ose të ulet ndjeshëm gjatë vitit 2023. Ndër 15 tregjet e vlerësuara në Perspektivën Globale të Hipotekës dhe Strehimit, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, Danimarka dhe Australia janë ndër vendet me perspektivat më të ulëta, pra me rënie në çmimet e patundshmërive prej 7% deri më 10%. Shpejtësia e rritjes së normave të interesit si rezultat i politikave të zbatuara nga bankat qendrore dhe papunësia e shkaktuar nga recesioni, përbëjnë bazën e prirjeve negative në çmimet globale të banesave.

PARASHIKIMET RRETH PERSPEKTIVËS SË SEKTORËVE PËR VITIN 2023



- Përkeqësimi i Perspektivës së Sektorit të Industrisë
- Përkeqësimi i Perspektivës së Industrisë
- Neutral
- Neutral
- Zhvillimet Pozitive në Sektorë të Ndryshëm
- Zhvillimet Pozitive në Sektorë të Ndryshëm



## *Nuk do të jetë një udhëtim i lehtë*

Pas luftës së nisur nga ana e Rusisë kundër Ukrainës dhe goditjeve të forta që kanë pësuar ekonomitë botërore të shkaktuara nga pandemia, në sipërfaqe duket se tregjet po shkojnë gradualisht drejt ekuilibrit. Pasi Kina rihapi tregëtinë pas pandemisë, ne shohim që ekonomia e saj po rimëkëmbet fuqishëm. Ndërprerjet në zinxhirin e furnizimit po zgjidhen dhe ndryshimet në tregjet e energjisë dhe ushqimit të shkaktuara nga lufta janë pakësuar. Njëkohësisht, shtrëngimi i kapitalit monetar nga shumica e bankave qendrore bën të mundur që disa ekonomi të arrijnë objektivat e tyre të inflacionit.

Sipas parashikimeve të IMF dhe WB, rritja globale do të arrijë në 2.8 për qind këtë vit dhe do të rritet në mënyrë modeste në 3.0 për qind në vitin 2024. Ndonëse me një ritëm më të ngadaltë se sa ishte parashikuar, inflacioni global do të bjerë gradualisht. Prandaj, inflacioni, i cili ishte 8.7 për qind në vitin 2022, pritet të bjerë në 7.0 për qind në fund të vitit 2023 dhe në 4.9 për qind në vitin 2024. Turrja dhe ngadalësimi ekonomik pritet të ndodhë kryesisht në ekonomitë e zhvilluara. Kjo turrje pritet që të intensifikohet veçanërisht në Eurozonë dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Simbas analizave të bëra nga WB, rritja ekonomike në këto rajone do të ulet në 0.7 për qind dhe -0.4 për qind në vitin 2023 dhe të rritet në 1.8 për qind dhe 2.0 për qind në vitin 2024. Në anën tjetër siç na kujton edhe paqëndrueshmëria e fundit e sektorit bankar në SHBA, tregjet botërore janë ende mjaft të luhatshme. Inflacioni doli të ishte shumë më rezistent se sa ishte parashikuar disa muaj më parë.

Për shkak të rezistencës së çmimeve, parashikimi i inflacionit për fundin e të njëjtit vit në fillim të vitit 2023 u rrit nga 4.5 për qind në 5.1 për qind. Ndërkohë që politikë kontraktuese monetare të përdorura për parandalimin e inflacionit pritet të kenë një efekt të drejtpërdrejtë në uljen e inflacionit, kërkesa për produkte nuk u ul aq sa pritej, kështu që në afat të shkurtër çmimet mbetën të njejta. Nga ana tjetër, në tremujorin e parë të vitit 2023, parashikimet rreth sektorit të prodhimit ashtu edhe ato të inflacionit janë rishikuar nga ana e FMN dhe WB. Si përfundim këto institucione kanë parë mundësinë e rritjes së çmimeve përtej pritshmerive të caktuara në fillim të vitit. Kjo e fundit mund të qoj në shtrëngim të mëtejshëm të politikës monetare ose të qëndrojë e shtrënguar për një periudhë më të gjatë kohore.

## *A duhet të shqetësohemi për rrezikun e një spiraleje të pakontrolluar të tarifave dhe çmimeve?*

Rritja e pagave nominale vijon të mbetet shumë më pas rritjes së çmimeve, duke treguar një rënie të mprehtë të pagave reale. Akoma më shqetësuese është se shtrëngimi i ashpër i politikave monetare gjatë 12 muajve të fundit ka filluar të ketë pasoja serioze për sektorin financiar. Pas një periudhe të gjatë me inflacion të ulët dhe normave jashtëzakonisht të ulëta të interesit, shtrëngimi i shpejtë i politikës monetare vitin e kaluar shkaktoi humbje të konsiderueshme në aktivet me të ardhura fikse afatgjata.



Paqëndrueshmëria financiare në tregun e arit në Mbretërinë e Bashkuar dhe trazirat e fundit bankare, me falimentimin e disa bankave rajonale në Shtetet e Bashkuara, tregojnë se ka dobësi të konsiderueshme si në mes të bankave ashtu edhe institucioneve financiare jobankare. Krizat sistematike financiare janë goditje që prishin funksione të rëndësishme të sistemit financiar, si alokimi i kredive, pagesat dhe vlerësimi i aktiveve, dhe shkaktojnë efekte negative në ekonominë reale. Nëse ndodh një krizë sistematike financiare, politikat e ndërmarra do të duhet të ripërshtatet me kujdes dhe në kohë për të mbrojtur si sistemin financiar ashtu edhe aktivitetin ekonomik. Ne po hyjmë në një periudhë të rrezikshme në të cilën sipas standardeve historike rritja ekonomike po mbetet e ulët dhe rreziqet financiare po rriten. Është e domosdoshme që në këtë periudhë politikëbërësit të ndërhyjnë në treg për ti parandaluar krizat e mundshme. Megjithatë, politika e duhur e veprimit varet nga gjendja e sistemit financiar. Nga ana tjetër, politika monetare e zbatuar ashtu siç është aktualisht duhet të fokusohet në uljen e inflacionit.

Ndërsa bankat vështirësojnë huadhënien për shkak të rritjes së kostove të financimit dhe nevojës për të vepruar me më shumë kujdes, kjo dukuri do të ndihmojë edhe në uljen e inflacionit. Një rol aktiv mund të luajë edhe politika fiskale më e shtrënguar. Ulja e shpenzimeve publike do të zvogëlojë aktivitetin ekonomik, do të mbështesë politikën e shtrënguar monetare dhe do të mundësojë që normat reale të interesit të kthehen më shpejt në nivelet e tyre të ulëta natyrore. Për shkak të çmimeve më të ulëta të mallrave, inflacioni total global pritet të bjerë nga 8.7 përqind në 2022 në 7.0 përqind në 2023, megjithëse inflacioni bazë (bazë) ka të ngjarë të bjerë më ngadalë. Në shumicën e ekonomive të zhvilluara dhe atyre në zhvillim e sipër, inflacioni nuk do të mund të kthehet në objektiv para vitit 2025. Sapo normat e inflacionit të kthehen në objektiva, faktorët më të thellë strukturorë ka të ngjarë të zbresin normat e interesit në nivelet e para pandemisë.



## VËSHIRËSITË ME TË CILAT MUND TË PËRBALLET SISTEMI FINANCIAR

### VËSHIRËSITË ME TË CILAT MUND TË PËRBALLET SISTEMI FINANCIAR

Pritet që pozicionet përgjithësisht të forta të likuiditetit dhe kapitalit të bankave të jenë në gjendje të thithin efektet negative të shtrëngimit të politikës monetare dhe në menyrë fleksibile ti përshtaten atyre. Megjithatë, disa institucione financiare me modele biznesi të besueshme vazhdojnë të shohin normat nominale jashtëzakonisht të ulëta të interesit të viteve të kaluara dhe janë të papërgatitur ose jo fleksibil për t'u përshtatur me rritjen e shpejtë të normave.

Në mesin e marsit të vitit 2023, tregjet financiare u kthyen përmbys pasi dështimet e papritura të dy bankave të specializuara rajonale në Shtetet e Bashkuara dhe rënia e besimit në bankën e rëndësishme globale Credit Suisse pati eksternalitet negativ në depozituesit dhe investitorët e bankave duke shtyer aktorët ekonomik të rivlerësojnë sigurinë e zotërimeve të tyre dhe largohen nga institucionet dhe investimet e perceptuara si të rrezikshme.

Pavarësisht përpjekjeve të forta të politikave për të mbështetur sektorin bankar dhe për të lehtësuar tregjet, disa depozitues dhe investitorë janë bërë shumë të ndjeshëm ndaj çdo lajmi teksa përpiqen të dallojnë gjerësinë e dobësive nëpër banka dhe institucione financiare dhe ndikimin e tyre të menjëhershëm në tregjet ndërkombëtare.

Para luhatjeve të fundit të sektorit financiar, në fillim të vitit 2023 aktiviteti në ekonominë botërore po shfaqte shenja stabilizimi dhe goditjet negative të vitit të kaluar kishin zbutur efektin e tyre. Pushtimi rus i Ukrainës dhe lufta e vazhdueshme shkaktuan goditje serioze të çmimeve të mallrave e energjisë si dhe ndërprerje të tregtisë, duke çuar në një riorientim dhe riorganizim të konsiderueshëm të shumë ekonomive. Megjithëse këto zhvillime penguan rimëkëmbjen, aktiviteti në shumë ekonomi rezultoi më i mirë se sa pritej në gjysmën e dytë të 2022. Megjithatë, me rritjen e fundit të paqëndrueshmërisë së tregjeve financiare, megjulla është intensifikuar sërish në të gjithë perspektivën ekonomike botërore.



## *Falimentimi i Bankave*

Silvergate Bank ishte një bankë e përdorur nga kompanitë e teknologjisë dhe kriptove dhe ishte një nga bankat që mbante kripto në asetet e saj. Sinjali se vlera e kriptovalutave do të vazhdon humbjen e vlerës së tyre çoi në sulm apo atak bankar, duke bërë që banka të falimentonte në një kohë shumë të shkurtër. Silicon Valley Bank, nga ana tjetër, ishte një bankë e madhe e përdorur nga kompanitë e Silicon Valley. Paniku pas rënies së Silvergate Bank shtoi zërat se Banka e Sillikon Valley, e cila përmbante shumicën e investimeve të projekteve të Silicon Valley, gjithashtu do të falimentojë. Si rezultat i sulmit bankar, banka u bë e paaftë për ti paguar paratë e depozitës dhe falimentoi. Me 200 miliardë dollarë aktive përpara mbylljes, Silicon Valley Bank ishte dështimi i tretë më i madh i një banke në histori.

Asetet e Silicon Valley Bank ishin 200 miliardë dollarë, ndërsa depozitat e bankës ishin rreth 170 miliardë dollarë. Pas panikut të shkaktuar, banka në fjalë nuk pati mundësinë ti shiste menjëherë asetet që zotëronte dhe t'i kthente ato në para likide kështuqë FDIC (Korporata Federale e Sigurimit të Depozitave) mori bankën. Megjithëse FDIC siguroi depozitat deri në 250,000 dollarë, depozitat e Silicon Valley Bank me vlerë 250,000 dollarë përbënin vetëm 2.7% të totalit të depozitave. Në total kishte 150 miliardë dollarë depozita të pasiguruara, pasi 97% e depozitave të mbetura kishin vlerë mbi 250,000 dollarë. Nga ana tjetër, qindra kompani humbën asetet e tyre sepse shumica e kompanive që investuan në Silicon Valley Bank ishin kompani të Silicon Valley. Në skenarin ku pjesa tjetër e depozitave nuk mund të financohej, aktivitetet ekonomike të kompanive pa kapital do të ndërpriteshin gjë që do të thoshte se qindra njerëz do të mesnin të papunë.



Gjithashtu edhe Signature Bank, i cili ishte një institucion financiar me lidhje të thella në industrinë e kriptomonedhave dhe me bazë në New York falimentoi menjëherë pas Sillikon Valley Bank. Sipas ekspertëve arsyeja kryesore e këtij falimentimi ishte nxitimi për tërheqjen e depozitave nga banka me frikën se bankës nuk i kanë mbetë asete dhe likuiditet i mjaftueshëm për ti paguar depozitat. Kjo atmosferë e sulmeve bankare është e lidhur ngusht me faktin se në muajt e fundit industrina e aseteve dixhitale është shumë e luhatshme dhe ka marrë një sërë goditjesh të mëdha. Guvernatorja e Nju Jorkut, Kathy Hochul u tha gazetarëve se kolapsi i Signature Bank u shkaktua pjesërisht nga rënia e Silicon Valley Bank, një tjetër institucion financiar i ndërthurur me strukturën e industrisë së teknologjisë.


Nga ana tjetër, në mjedise të tilla si sulme paniku në banka dihet se investitorët priren të tërheqin paratë e tyre nga bankat dhe t'i investojnë në ari. Kjo situatë tregon arsyen e rritjes së çmimit të arit në këto periudha. Ndërkohë që vlera e të gjitha aktiveve është ulur, mbiçmimi i arit tregon se besimi i investitorëve tek bankat është ulur dhe ata kanë prirje më shumë të investimit në flori.

Në këtë rast, brishtësia dhe eksternaliteti negativ i sektorit financiar mund të rritet, kështu që një përkeqësim i mprehtë i kushteve të financimit mund të dobësojë ekonominë reale dhe ti detyroj bankat qendrore të rishqyrtojnë politikën e tyre. Gjithashtu ndarja në blloqe gjeopolitike mund të rezultojë në humbje masive të prodhimit, duke përfshirë efektet e saj në investimet e huaja direkte. Qëndrueshmëria afatmesme e borxhit do të kërkojë konsolidim fiskal në kohën e duhur dhe, në disa raste edhe ristrukturim të borxhit. Hapat për të forcuar bashkëpunimin shumëpalësh mes vendeve, duke përfshirë forcimin e rrjetit global të sigurisë financiare, zbutjen e kostove të ndryshimeve klimatike dhe zbutjen e efekteve negative të fragmentimit gjeoekonomik, janë vendimtare në krijimin e një ekonomie botërore më të qëndrueshme.


## Perspektiva Ekonomike Botërore 2023

# Parashikimet e rritjes Ekonomike


### Ekonomia globale



### Ekonomitë në zhvillim e sipër



### Ekonomitë e zhvilluara




Parashikimi bazë, duke supozuar se dobësitë e fundit të sektorit financiar janë nën kontroll, është se Rritja Globale do të bjerë nga 3.4 përqind sa ishte në vitin 2022 në 2.8 përqind në vitin 2023 dhe pastaj nga fundi i vitit do të rritet ngadalë në 3.0 përqind. Këto vlerësime të bëra nga institucionet ekonomike janë vlerësimet afatmesme më të ulëta që kanë bërë këto vitet e fundit.

Nëse jostabiliteti i sektorit financiar vazhdon të rritet më tej atëherë rritja globale mund të bjerë në rreth 2.5 përqind deri në fund të vitit 2023. Kjo e fundit do të ishte rritja më e dobët globale që nga recesioni global në 2001. Sidomos ekonomitë e zhvilluara pritet të shohin një rënie të ndjeshme nga shifrat mesatare të rritjes prej 2.7 përqind sa ishte në vitin 2022 në 1.3 përqind gjatë vitit 2023.


Për ekonomitë në zhvillim e sipër, vlerësohet se shifra e rritjes, e cila ishte 4.0 në vitin 2022, do të jetë 3.9 deri në fund të vitit 2023 dhe se si rezultat i politikave ekspansjoniste rritja ekonomike do të arrijë në 4.2 në vitin 2024.

## Parashikimet e rritjes ekonomike sipas rajoneve


### EKONOMIA GLOBALE




### SHBA




### Lindja e Mesme dhe Azia Qendrore




### Eurozona




### Amerika Latine



### Azia




### Afrika




## Parashikimet e rritjes për ekonomitë e zhvilluara

### Eurozona

#### Gjermania



Rritja reale e PBB-së, %




Rritja reale e PBB-së, %

#### Franca



Rritja reale e PBB-së, %

#### Turqia




Rritja reale e PBB-së, %

#### Spanja




Rritja reale e PBB-së, %

#### Italia



Rritja reale e PBB-së, %

#### Belgjika




Rritja reale e PBB-së, %



## Perspektiva Ekonomike Botërore 2023

# Parashikimet e rritjes ekonomike për vendet e Ballkanit



## *Perspektiva ekonomike e vendeve në zhvillim të Ballkanit Perëndimor*

### **KOSOVA**

Pavarësisht sfidave të përjetuara në nivel global, në gjysmën e parë të vitit 2023 kushtet makroekonomike në Kosovë kanë ndjekur një rrugë pozitive. Prandaj, ndërkohë që rritja vazhdon të jetë e qëndrueshme, inflacioni krahasuar me një vit më parë po vazhdon të bjerë dhe deficitet i llogarisë korente ka filluar të ngushtohet.

Ndërkohë që të ardhurat fiskale po rriten me ritme të shëndetshme, zbatimi i programit të investimeve publike po përshpejtohet dhe tamponët fiskalë mbeten në nivelet e duhura. Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive ekonomike në bazë të vendit, tensionet në veri të Kosovës mund të pengojnë investimet e mundshme në vend. Parashikimet se Kosova është një vend i rrezikshëm për investitorët e huaj për shkak të zhvillimeve në veri të vendit mund të bëjë që investimet me vlerë të shtuar të lartë të largohen. Në këtë rast akterët ekonomik dhe investimet që mund të përshpejtojnë shumë ekonominë e vendit nëpërmjet efektit shumëfishues të parasë do të zhduken.

Zhvillimet e fundit në komunat e veriut kanë bërë që disa donatorë dhe partnerë të lidhur me BE-në të miratojnë masa të përkohshme dhe të kthyeshme që kufizojnë bashkëpunimin ekonomik dhe financiar. Nëse këto masa vazhdojnë në terma afatgjatë, ato mund të përbëjnë pengesë për investimet e huaja direkte dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi.

### **MAQEDONIA VERIORE**

Maqedonia e Veriut është në proces të rimëkëmbjes ekonomike. Rritja reale e PBB-së ishte 2.1% këtë vit ndërsa vlerësohet që do të jetë 3.4% në vitin 2024. Në muajt e fundit, i nxitur nga rënia e çmimeve të energjisë dhe ushqimeve, si dhe nga shtrëngimi i vazhdueshëm i politikës monetare inflacioni ka filluar të bjerë. Çmimet e konsumit pritet të rriten mesatarisht me 9.2% këtë vit dhe me 3.5% në 2024.

Duke qenë se rritja e çmimeve të konsumit në vitet e fundit ka ulur fuqinë blerëse të familjeve, është e kuptueshme që punonjësit publikë kërkojnë paga më të larta. Në buxhetin e qeverisë qendrore vihet re një rritje e niveleve të pagave të barabarta me normën 10% të inflacionit të parashikuar për vitin 2023. Rritja e pagave mbi këtë normë do të krijojë një barrë të madhe dhe të përhershme në buxhet dhe do të sjellë me vete edhe rrezikun e shkurtimit të shpenzimeve të tjera shtetërore. Nga ana tjetër, rritjet e mëdha të pagave mund të sjellin rrezikun e shndërrimit të inflacionit të lartë të përkohshëm në inflacion të lartë të përhershëm.

Ndërsa reforma e tarifave të bllokut të energjisë elektrike në vitin 2022 është një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur, çmimet e energjisë elektrike për shumicën e familjeve mbeten të subvencionuara dhe ndër më të ulëtat në Evropë. Si rezultat, financat publike mbeten të pambrojtura ndaj rritjes së kostove të energjisë. Edhe pse rritja e tarifave të energjisë nuk është kurrë e lehtë, do të jetë e rëndësishme të vazhdohet me reformat e tarifave të energjisë elektrike që heqin dorë nga subvencionet dhe forcojnë efikasitetin e energjisë.

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (BPRMK) vazhdon të ndërmarrë hapat e nevojshëm në politikën monetare përmes normave më të larta të politikës dhe masave të tjera për të siguruar që inflacioni i lartë të mos bëhet i përhershëm. Këto ndryshime politikash do të ndihmojnë në stabilizimin e pritjeve inflacioniste dhe do të kontribuojnë në një rënie graduale të inflacionit. Më e rëndësishmja, këto politika sigurojnë gjithashtu që rezervat ndërkombëtare të mbeten të mjaftueshme, gjë që është një faktor shumë i rëndësishëm për të ruajtur qëndrueshmërinë e ekonomisë së Maqedonisë së Veriut. Sistemi bankar mbetet likuid, fitimprurës dhe i kapitalizuar në mënyrë adekuate, duke i mundur atij të absorbojë efektet negative të kushteve më të shtrënguara financiare dhe goditjeve të tjera.

# Perspektiva ekonomike e vendeve në zhvillim të Ballkanit Perëndimor



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI  
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE  
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

## Shqipëria

Ekonomia e Shqipërisë performoi mbi pritshmëritë, duke u rritur me 4.8% në vitin 2022 dhe kjo falë kërkesës së fortë të konsumatorit, fluksit turistik dhe aktiviteteve të ndërtimit. Me ritjen e vlerës së lekut, deficitet e llogarisë korente dhe fiskale janë ngushtuar ndjeshëm.

Rritja ekonomike pritet të ngadalësohet në rreth 3 për qind për vitin 2023 për shkak të rritjes së ngadaltë të partnerëve tregtarë, tërheqjes së mbështetjes së politikave dhe shtrëngimit të kushteve financiare. Edhe pse pas zbatimit të politikës monetare të shtrënguar, niveli i inflacionit ka filluar të ulet ai vazhdon të mbetet shumë mbi objektivin e vendosur nga banka qendrore. Reduktimi i mëtejshëm i inflacionit është thelbësor për mbrojtjen e familjeve veçanërisht të cenueshme. Prandaj, rritja e normës bazë në muajin mars është një nga hapat e rëndësishëm të ndërmarrë drejt normalizimit të politikës monetare dhe uljes së inflacionit.

Nga ana tjetër, perspektiva ekonomike globale ende mbart një nivel të lartë pasigurie. Rritja më e ngadaltë se sa pritej e partnerëve tregtarë mund të ndikojë në rrënje të eksporteve dhe rritjes ekonomike të Shqipërisë. Tregjet e shtrënguara të punës dhe rritjet e mëdha të pagave në sektorin publik mund të reflektohet në pagat e sektorit privat ku kjo do të shkaktonte rritje të mëtutjeshme të inflacionit. Nëse inflacioni vazhdon të jetë më i qëndrueshëm se sa pritet atëher do të duhet të ketë rritje të normave të interesit edhe pse kjo ka mundësi të përfundon me tkurrje ekonomike. Në rrastet kur inflacioni ka rritje të vazhdueshme është shumë e rëndësishme që politikat monetare të jenë fleksibile dhe të veprojnë sa më shpejtë.

Megjithëse sistemi bankar është treguar i qëndrueshëm ndaj goditjeve të njëpasnjëshme, shtrëngimi i kushteve financiare mund të nxjer në pah dobësi të reja në ekonominë reale.

# Perspektiva ekonomike e vendeve në zhvillim të Ballkanit Perëndimor



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI  
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE  
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

Në përgjithësi, sistemi bankar ka pozicione të shëndosha kapitali dhe likuiditeti, por nivelet e larta të kredive me probleme mund të dëmtojnë kapitalin. Në këtë kuadër, përpjekjet e Bankës së Shqipërisë për të rritur rregullimin dhe mbikëqyrjen, duke përfshirë krijimin gradual të rezervave më të larta të kapitalit bankar, do të vijojnë të mbrojnë sektorin financiar ndaj dobësive.

## **Mali i Zi**

Lufta e Rusisë në Ukrainë pati ndikim të madh në ekonominë malazeze. Ndërsa inflacioni arriti nivele rekord, rusët dhe ukrainasit që banonin përkohësisht dhe për periudha të shkurta në Mal të Zi mbështetën konsumin, hyrjet valutore dhe rritjen ekonomike të vendit. Megjithatë pritet që rritja të ngadalësohet vitin e ardhshëm dhe inflacioni të ulet gradualisht.

Rritja e fortë e të ardhurave në ekonomi maskon dobësitë themelore fiskale. Në afat të mesëm, është e domosdoshme ruajtja e qëndrueshmërisë së financave publike duke kontrolluar deficitin fiskal dhe duke ulur borxhin publik. Sektori financiar në përgjithësi ka qenë elastik ndaj turbullirave të shkaktuara nga pandemia, me kapital të fortë dhe buferë likuiditeti në të gjithë sistemin.

Çmimet e larta globale të ushqimeve dhe energjisë kanë bërë që inflacioni të rritet në nivele rekord prej 17%. Për shkak të çmimeve të larta të importeve, deficitin i llogarisë korente pritet të rritet këtë vit gjithashtu edhe rritja ekonomike pritet të ulet në vitin 2023.

Inflacioni ka të ngjarë të bjerë në vitin 2023 në varësi të shkallës në të cilën çmimet e importit stabilizohen ose bien, por është jetike të mbahen nën kontroll edhe presionet e pagave. Aktualisht vlerësohet se inflacioni do të mbetet i lartë në rreth 9-10 për qind.





## *Perspektiva ekonomike e vendeve në zhvillim të Ballkanit Perëndimor*

Kur shikojmë tregun e punës shohim se rritja e ndjeshme e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ndihmoi në kthimin e shkallës së papunësisë në nivelet e para pandemisë. Rritja e madhe e pagës minimale në fillim të vitit pati një ndikim të rëndësishëm në punësimin formal.

Është e domosdoshme që deficitin fiskal të merret nën kontroll në vitet e ardhshme. Financimi i deficiteve të mëdha fiskale krahas rritjes së shlyerjes së borxhit do të jetë sfidues, veçanërisht në një mjedis me norma të larta interesi. Në varësi të kushteve aktuale financiare globale, ritmi i kërkuar i rregullimit financiar mund të duhet të jetë më i shpejtë. Për të ruajtur qëndrueshmërinë e financave publike, shpenzimet e pafinancuara ose shkurtimet e taksave do të duhet të shmangen. Pavarësia e bankës qendrore është kritike për besueshmërinë dhe stabilitetin e sistemit financiar.

## KONKLUZIONI

Rritja globale parashikohet të bjerë nga 3,5 për qind sa ishte në vitin 2022 në 3,0 për qind gjatë viteve 2023 dhe 2024. Rritja e normave të interesit të politikës së bankës qendrore për të luftuar inflacionin vijon të ushtrojë presion mbi aktivitetin ekonomik, duke bërë që investimet të mbeten të kufizuara. Inflacioni total global pritet të bjerë nga 8.7 përqind në 2022 në 6.8 përqind në 2023 dhe 5.2 përqind në 2024. Sipas ekonomistëve inflacioni total (bazë) pritet të bjerë më gradualisht.

Hapat e fuqishëm të ndërmarrë nga autoritetet për të kontrolluar turbulencat në bankat amerikane dhe zvicerane pas miratimit të marrëveshjes së tavanit të borxhit, e cila përcakton ligjërisht shumën maksimale që qeveria amerikane mund të marrë hua, kanë reduktuar rreziqet e trazirave në sektorin financiar. Kjo perspektivë sado pak zbuti pritshmëritë dhe rreziqet negative të aktorëve ekonomikë. Megjithatë, pritshmëritë për rritjen globale mbeten ende negative. Nivelet e inflacionit mund të mbeten të larta dhe të rriten më tej si rezultat i goditjeve të papritura që mund të ndodhin në tregjet ndërkombëtare. Ndër ngjarjet më të mundshme për të shkaktuar këtë situatë është intensifikimi i luftës në Ukrainë dhe mangësitë në zingjirin e ushqimit të cilat mund të shkaktohen nga përkeqësimi i kushteve të motit.

Nëse marrim parasysh skenarin pozitiv, nëse inflacioni bie më shpejt se sa pritej, nevoja për politikë të shtrënguar monetare mund të ulet dhe kërkesa e brendshme mund të bëhet sërish më elastike.

Si rezultat, prioriteti në shumicën e ekonomive është ulja e vazhdueshme e inflacionit duke siguruar stabilitetin financiar. Prandaj, bankat qendrore duhet të fokusohen në rivendosjen e stabilitetit të çmimeve dhe të forcojnë mbikëqyrjen financiare dhe monitorimin e rrezikut. Nëse ndodhin lëvizje të papritshme në treg, vendet duhet të sigurojnë likuiditet menjëherë për të shmangur mundësinë e rrezikut moral. Gjithashtu, si rezultat i ngjarjeve të pafavorshme ekonomike duhet të krijohen tamponë fiskalë përmes rregulloreve fiskale që ofrojnë mbështetje të synuar për segmentet më të cenueshme të shoqërisë. Përmirësimet në anën e ofertës së ekonomisë do të lehtësojnë konsolidimin fiskal dhe do të ndihmojnë në sigurimin e një tranzicioni më të butë të inflacionit drejt niveleve të synuara.